

VENDIM
Nr.18, datë 29.4.2020

**PËR MIRATIMIN E LISTËS ME STRUKTURAT E REJA AKOMODUESE PËR
AKOMODIMIN E PËRKOHSHËM TË PERSONAVE QË RIATDHESOHEN SI
REZULTAT I GJENDJES SË SHKAKTUAR NGA COVID-19**

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, dhe të vendimit nr.311, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit të akomodimit të përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga COVID-19”, Komiteti Ndërmnistror i Emergjencave Civile, i mbledhur sot në datën 29.4.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e listës me strukturat e reja akomoduese, të cilat i shtohen listës së përditësuar të strukturave akomoduese, të miratuara me vendimin nr.14, datë 23.4.2020, të Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, për akomodimin e përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga COVID-19.

2. Ngarkohen prefektët e qarqeve Korçë dhe Gjirokastrë që të organizojnë procesin e transportit dhe të monitorojnë akomodimin e personave të riatdhesuar në strukturat akomoduese, sipas listës së miratuar me këtë vendim, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të parashikuara në vendimin nr.311, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit të akomodimit të përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga COVID-19”.

3. Ngarkohen prefektët e qarqeve Shkodër dhe Kukës që të organizojnë procesin e transportit dhe të monitorojnë akomodimin e personave të riatdhesuar në strukturat më të afërta akomoduese, sipas listës së miratuar me vendimin nr.14, datë 23.4.2020, të Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile, për akomodimin e përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga COVID-19, në bashkëpunim me institucionet e përcaktuara në vendimin nr.311, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit të akomodimit të përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga COVID-19”.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe prefektët e qarqeve Korçë, Gjirokastrë, Shkodër dhe Kukës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR I KOMITETIT NDËRMNISTROR
TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINISTËR
Edi Rama**

**LISTA E PËRDITËSUAR E STRUKTURAVE AKOMODUESE TË EVIDENTUARA
NGA UTSH DHE ATA DHE TË DAKORDËSUAR NGA MTM**

Nr.	Emri hotelit	Vendndodhja Hotelit
1.	Hotel “AS”	Golem
2.	Hotel “Ibiza”	Golem
3.	Hotel “Bonita”	Golem
4.	Hotel “Sun”	Durrës

5.	Hotel “Gloria”	Golem
6.	Hotel “Horizont”	Durrës
7.	Hotel “Brilliant”	Golem
8.	Hotel “Kolaveri”	Mali i Robit
9.	Hotel “Fafa”	Golem
10.	Hotel “Eter”	Mali i Robit
11.	Hotel “Dolce Vita”	Golem
12.	Hotel “Brothers Dijon”	Golem
13.	Hotel “Alvin”	Golem
14.	Hotel “Belmondo”	Golem
15.	Hotel “Bleart”	Golem
16.	Hotel “Casa”	Golem
17.	Hotel “Rafaelo”	Lezhe
18.	Hotel “Kristali”	Korcë
19.	Hotel “Pacili”	Korcë
20.	Hotel “Alysa”	Korcë
21.	Hotel “Medi Nako”	Korcë
22.	Hotel “Eurokorca”	Pogradec
23.	Hotel “Kalaja”	Pogradec
24.	Hotel “Cajupi”	Gjirokastër
25.	Hotel “Number One”	Gjirokastër